REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 2873 Prot. Tiranë, më 31.12.2025

U R D H Ë R

Nr. 400, datë 31.12.2025

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR MËNYRËN DHE AFATET E PARAPAGIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrit nr. 268, datë 04.09.2025, "Për miratimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit",

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Rregullores së Brendshme "Për mënyrën dhe afatet e parapagimit të tarifave të shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë".
2. Ngarkohen për zbatimin e kësaj Rregulloreje të Brendshme të gjitha strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.
3. Kjo rregullore zbatohet deri në momentin e miratimit të udhëzimit të ri "Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të DPM".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Llaka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË - TIRANË - MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

RREGULLORE E BRENDSHME

PËR

MËNYRËN DHE AFATET E PARAPAGIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE

A. PROCEDURA QË NDIQET NGA STRUKTURAT E DPM:

1. **Mbledhja e tarifave** apo pagesave për shërbime kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), përmes specialistëve të sektorëve të shërbimit dhe sektorit të financës, të cilët janë struktura përbërëse të kësaj drejtorie.
2. **Specialistët e sektorëve të shërbimit**, bazuar në grafikët periodikë dhe/ose kërkesat e subjekteve juridikë, që i nënshtrohen detyrimeve të nenit 20, të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", i ndryshuar, kryejnë shërbimet metrologjike, për instrumente matës që i nënshtrohen kontrollit ligjor dhe lëshojnë faturën për arkëtim, referuar ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. **Sektori i financës**, në bazë të kërkesave të subjekteve, referuar gërmës n, të nenit 8, neneve 16, 20 dhe 39, të ligjit nr. 126/2020 "Për Metrologjinë", i ndryshuar, lëshon faturën për arkëtim referuar ligjit nr. 87/2019 dhe aktet nënligjore përkatëse.
4. Subjekti duhet të vërtetojë kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse (si p.sh. tarifa e verifikimit/kalibrimit/monitorimit/autorizimit/trajnimit) pranë specialistëve të shërbimit ose sektorit të financës. Pas konfirmimit të pagesës së tarifës, lëshohet fatura e fiskalizuar. Shërbimi dhe faturimi duhet të përfundojnë brenda muajit kalendarik, por jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës, referuar ligjit nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".
5. Për **pagesat në dorë**, përdoret fatura e fiskalizuar (kuponi tatimor), e cila jepet si dokument financiar për subjektet që kanë kërkuar shërbim metrologjik.

   Specialistët e sektorëve të shërbimit mund të marrin pagesa tarife deri në 10,000 lekë (me TVSH) në dorë. Për shumën mbi 10,000 lekë, pagesa kryhet me transfertë bankare (xhirim në llogari).

6. **Afatet e parapagimit të tarifave** fillojnë nga momenti i:

   a) lëshimit të faturës për arkëtim, e cila duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike (për pagesat me transfertë bankare).

   b) kërkesës dhe konfirmimit të subjektit për kryerjen e pagesës me para në dorë (për tarifa deri në 10 000 lekë, referuar pikës 5, të kësaj rregulloreje).

7. Asnjë shërbim metrologjik nuk kryhet pa u bërë parapagimi i tarifës përkatëse nga subjekti.

8. **Data e mbylljes së aktivitetit mujor** është data e fundit e çdo muaji. Specialistët dhe sektori i financës do të bëjnë kalimin e të ardhurave të realizuara, përmes faturave për arkëtim, në llogarinë e të ardhurave në Degën e Thesarit Tiranë.

   Arkëtimi bëhet një herë në javë dhe arkëtimi përfundimtare bëhet në datën e fundit të muajit. Nëse kjo datë bie në ditë pushimi, arkëtimi kryhet në ditën e punës më të afërt, brenda muajit.

   a) Lëshimi i faturës së arkëtimit për efekt të arkëtimit të ardhurave të mbledhura

   Për çdo arkëtim të të ardhurave në bankë, specialisti është i detyruar të lëshojë një faturë arkëtimi për llogari të tij. Kjo faturë shërben si dokument justifikues për shumën e arkëtuar dhe është pjesë integrale e procesit të fiskalizimit.

   b) Përputhshmëria me faturat e fiskalizuara

   Shuma e arkëtuar në bankë duhet të jetë e barabartë me totalin e faturave të fiskalizuara deri në datën e arkëtimit.
   Nuk lejohet arkëtimi e një shume të pjesshme ose që nuk ka mbulim me fatura të fiskalizuara.

   c) Qëllimi i procedurës

   Kjo procedurë synon të sigurojë transparencë të plotë në lëvizjet financiare, përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi dhe shmangie të çdo mospërputhjeje ndërmjet të ardhurave të deklaruara dhe atyre të arketuara në bankë.

9. **Arkëtimi dhe rakordimi i të ardhurave nga tarifat bëhet si më poshtë:**

   a) Të gjitha të ardhurat nga shërbimet metrologjike kalojnë drejtpërdrejt në llogarinë e DPM në Thesar.

   b) Përgjegjësi i Sektorit të Financës raporton elektronikisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve brenda afateve ligjore. Po ashtu, paguhet edhe TVSH për të ardhurat e deklaruara.

10. **Arkëtimi i të ardhurave** për DPM bëhet në Degën e Thesarit me:

    Kod distrikti: 35354
    Kod institucioni: 1004205
    referuar faturës për arkëtim dhe llogarive ekonomike të miratuara. Pagesa e TVSH-së bëhet përmes deklaratës tatimore të sistemit informatik tatimor.

11. **Zbatimi i tarifave të shërbimit** është përgjegjësi individuale e çdo specialisti dhe kontrollohet nga përgjegjësi i sektorit përkatës.
12. **Procedura për kërkesat për shërbime kalibrimi** kryhet referuar dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë:

    - DPM-PO-16: "Trajtimi i pajisjeve për kalibrim"
    - DPM-PO-19: "Rishikimi i kërkesave të klientëve"

    Procesi i kalibrimit nuk kryhet pa u konfirmuar pagesa nga subjektet përkatëse.

13. **Mosrespektimi i dokumentacionit** sipas ligjit të fiskalizimit, rregullave të brendshme apo afateve të përcaktuara, konsiderohet shkelje disiplinore dhe ndaj personave përgjegjës zbatohen masat përkatëse ligjore apo nënligjore.
14. **Pasqyrat që duhet të plotësojnë specialistët**

    1. **Pasqyra nr. 3**: Pasqyrë e të ardhurave të realizuara nga çdo specialist, e cila plotësohet nga vetë specialisti. Përgjegjësi i sektorit e plotëson pasqyrën nr. 3, një herë në muaj për gjithë sektorin dhe dorëzohet në sektorin e financës.

    2. **Pasqyra e faturave të palikujduara (debitorët)**: Liston të gjitha faturat për arkëtim të lëshuara dhe të palikujduara brenda muajit nga specialisti.

    3. **Pasqyra nr. 8: "Të ardhura nga arkëtimet"**: Evidenton të gjitha vlerat e realizuara gjatë muajit. Plotësohet në 2 kopje: një për Sektorin e Financës dhe një për Sektorin e Shërbimit. Rubrikat që përmban:

    a) "Fatura për arkëtim të arkëtuara nga subjektet": Faturat e paguara nga subjektet dhe të fiskalizuara.

    b) "Fatura për arkëtim të arkëtuara nga specialisti": Faturat e paguara nga specialisti në bankë, për tarifat e arkëtuara me para në dorë.

    c) "Fatura për arkëtim të palikujduara": Faturat që nuk janë shlyer nga subjektet. Shuma e rubrikës "a" dhe "b" duhet të jetë e barabartë me realizimin faktik të specialistit dhe të pasqyrës nr. 3.

    Gjithashtu, çdo specialist duhet të plotësojë formatin Excel të miratuar (regjistër) me të dhënat për instrumentet e verifikuara dhe ta dërgojë në mënyrë elektronike pranë DML.